

Turqia zyrtarisht ka inauguruar xhaminë më të madhe të vendit, e cila ndodhet në një kodër me pamje nga ngushtica e Bosforit dhe e dukshme nga i gjithë Stambolli, raporton Anadolu Agency (AA).

Presidenti turk, Recep Tayyip Erdoğan, mbërriti për namazin e xhumasë në kompleksin e xhamisë "Çamlıca", xhami e cila është projektuar me një kapacitet prej 63 mijë besimtarëve.

Në ceremoninë e hapjes së xhamisë "Çamlıca" të pranishëm ishin presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, presidenti i Guinesë, Alpha Conde, presidenti i Senegalit, Macky Sall dhe kryeministri i Palestinës, Mohammad Shtayyeh, së bashku me disa përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë.

E ndërtuar në stilin osman të arkitekturës "Selxhuk", xhamia është e dukshme nga i gjithë qyteti i Stambollit.

Përveç xhamisë, kompleksi përmban një muze të artit turk islam, si dhe një bibliotekë, galeri arti, sallë konferencash dhe disa punëtori.

Gjashtë minaret e saj përfaqësojnë gjashtë shtyllat e besimit. Katër prej tyre janë 107.1 metra të larta, në shenjë simbolike për fitoren e turqve Selxhuk në qytetin e Turqisë lindore Malazgirt në vitin 1071 kundër ushtrisë bizantine.

Kupolla e saj e lartë 72 metra përfaqëson 72 kombet që jetojnë në qytet. Kupolla e dytë, me një diametër prej 34 metrash, përfaqëson numrin zyrtar të licencës së Stambollit.

Gjashtëmbëdhjet emra të Allahut janë gdhendur në muret e brendshme të kupollës, duke simbolizuar numrin e shteteve të themeluara nga turqit gjatë historisë.

Një ulëse tri-pjesëshe në kupolën kryesore peshon 4.5 tonë dhe ka një lartësi prej 7.77 metra dhe është më e madhja e këtij lloji.

Në dyshtemenë e xhamisë është shtruar një qilim 17 mijë metra katror i punuar me dorë, si dhe minberi 21 metra i lartë që mund të ngrihet përmes ashensorit, ku do të mbahen predikimet e xhumasë dhe festave të tjera fetare.